



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 ATK në 248 raste kishte vonesa në trajtimin e kërkesave të tatim paguesve për kthim/rimbursim tatimor brenda afatit ligjor;
- C1 Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale;
- B2 Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes;
- A1 Në ATK, kishte pozita të mbajtura të punës me zëvendësues jo në harmoni me legjislacionin në fuqi; dhe
- A2 Menaxhimi i kontratave nuk është administruar përmes platformës së prokurimit elektronik (e-prokurimi).

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Ministria gjatë vitit 2025 ka funksionuar si një entitet i vetëm, ndërsa nga viti 2026 është ndarë në dy institucione të veçanta: Ministria e Financave (MF) dhe Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ), me buxhete përkatëse të ndara. Për këtë arsye, rekomandimet e këtij raporti u adresohen të dyja ministrive, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretar i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretar i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Minister është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat ishin efektive, me përjashtim të vonesave në shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve për kthim/rimbursim tatimor, të cilat vazhdojnë të jenë prezente edhe këtë vit.

Kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Mangësitë kryesisht janë vërejtur në klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve me theks të veçantë tek ekzekutimi i pagesave nga vendimet gjyqësore.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi, nuk janë përmbushur kërkesat ligjore për sa i përket menaxhimit të kontratave përmes platformës e-prokurimi, si dhe në ATK kishte një numër të madh të pozitave të punës të mbajtura me zëvendësues/ushtrues detyre në mos harmoni me legjislacionin në fuqi.

Këtë vit është vërejtur një rënie e gabimeve financiare në raport me vitin paraprak në lidhje me pagesat e më shumë se një pensioni për përfituesit, ndërsa tek pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve kishte rritje të gabimit këtë vit.

Sa i përket shpalosjeve, menaxhimi i pasurisë mbetet ende sfidë për tu adresuar plotësisht pasi që disa pasuri të ministrisë nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive si dhe inventarizimi i pasurisë nuk është kryer me kohë në Doganën e Kosovës. Një vëmendje më e shtuar duhet kushtuar paraqitjes së saktë të llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve kontigjente në PFV, pasi kemi identifikuar disa mangësi këtë vit.

Sa i përket zbatimit të mbikëqyrjes ndaj NJAB-së, Komiteti i auditimit në MFPT nuk ishte funksional gjatë vitit 2025.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, shtatë (7) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Vonesë në shqyrtimin e kërkesave për kthim/rimbursim tatimor nga ATK

- Gjetja** Neni 26 i ligjit nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore obligon ATK-në që brenda 30 ditëve të shqyrtoj dhe aprovoj kërkesën nga tatimpaguesit për kthim/rimbursim tatimor. Nëse kërkesa për kthim/rimbursim është aprovuar nga ATK mirëpo është tejkaluar afati ligjor, atëherë duhet të paguhet edhe interes tatim paguesve për vonesa.
- Nga testimet dhe analiza e bazës së kthimeve/rimbursimeve, identifikuam 248 raste nga gjithsej 1,085 kërkesa të aprovuara, ku ATK nuk i kishte shqyrtuar kërkesat e tatim paguesve për kthim/rimbursim tatimor brenda afatit ligjor. Këto vonesa ishin nga 1 deri në 582 ditë kalendarike apo mesatarisht rreth 41 ditë përtej afatit ligjor. Për këto vonesa, ATK nuk kishte aplikuar pagesën e interesit ndaj tatim paguesve.
- Procesi i trajtimit të kërkesave për kthim/rimbursim nga ATK nuk ishte mjaftueshëm efikas. Kapacitetet e kufizuara të stafit, sipas menaxhmentit, kanë ndikuar në paraqitjen e vonesave në trajtimin e këtyre kërkesave.
- Ndikimi** Vonesat në kthime/rimbursime tatimore, ju shkaktojnë bizneseve vështirësi financiare në ushtrimin e aktiviteteve të tyre operative dhe në anën tjetër rrisin rrezikun që ATK të jetë subjekt i padive nga tatim paguesit si pasojë e mos pagesës së interesit.
- Rekomandimi B1** Ministri i Financave duhet të sigurojë përmes drejtorit të ATK-së menaxhim më efikas në procesin e shqyrtimit të kërkesave për kthime/rimbursime, në mënyrë që të trajtohen brenda afatit të përcaktuar ligjor. Po ashtu, të analizoj shkaqet që kanë shkaktuar ngecjen, përfshirë kapacitetet aktuale, dhe të ndërmarrë veprime përkatëse për adresimin e tyre duke shtuar fokusin në trajtimin e kërkesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale**Gjetja**

Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, rregullon pensionet bazë të moshës, pensionet kontribut pagues të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalide të punës. Sipas nenit 16 të këtij ligji, personat të cilët janë përfitues të cilitdo pension të skemave të përcaktuara me këtë ligj në asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni tjetër nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen nga shteti.

Sipas ligjit Nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre - neni 5.1.4 përfituesit e pensioneve familjare, invalidor personal dhe invalidor familjar nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është e përcaktuar me ligj.

Sipas ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së neni 16 pika 2, Veteranët e UÇK-së nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse veterani është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti duhet të përcaktohet se cilin pension do ta marrë.

Sipas ligjit Nr. 04/L-084 për pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, neni 5.3 përfituesit që kanë të drejtë në pensionin e FSK-së duhet të zgjedhin njërin nga përfitimet: pensionin që u takon me këtë ligj, apo përfitimet tjera që parashihen me ligjet tjera në fuqi.

Për këtë qëllim është e rëndësishme të theksohet se Ligji nr.03/L-100 për Pensionet e pjesëtarëve të TMK-së nuk ka ndonjë dispozitë ligjore e cila në mënyrë të qartë ua njeh të drejtën e vazhdimit të marrjes së pensionit të TMK-së nëse personat e njëjtë gëzojnë edhe ndonjë pension tjetër nga skema pensionale.

Bazuar në krahasimin e të dhënave të Ministrisë për skemat pensionale dhe sociale kemi identifikuar se Ministria kishte kryer pagesa në vlerë 926,553€ për përfitues të cilët gëzojnë më shumë se një pension. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një ulje të lehtë të gabimit të identifikuar. Rastet më të shpeshta të përfitimit të më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, janë përfituesit që i takojnë kategorisë së TMK-së, të cilat pagesa Ministria i kishte kryer edhe vitin e kaluar bazuar në vendimin e ish Kryeministrit nr.12/82 të datës 28.12.2018. Me këtë vendim ishte aprovuar vazhdimi i pagesave të pensioneve të dyfishta për FSK dhe ish-pjesëtarët e TMK-së deri në interpretimin përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale.

Tabela 1. Përfituesit e më shumë se një pensioni nga skemat pensionale

Nr.	Lloji i Skemës	Numri i pagesave	Gabimi Financiar (EUR)
1	Pensionet e Forcës Së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL Familjar	-	-
2	Pensionet e Forcës Së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL Veteran	-	-
3	Pensionet e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës TMK dhe DFDIL Familjar	5,130	1,082,073
4	Pensionet e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës TMK dhe DFDIL Veteran	12	1,714
5	Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL Familjar	-	-
6	Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL Veteran	-	-
7	Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL Familjar	-	-
8	Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL Veteran	-	-
9	Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK) dhe DFDIL Familjar	-	-
10	Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK) dhe DFDIL Veteran	-	-
11	DFDIL Familjar dhe PIP	-	-
12	Trepça dhe DFDIL Veteran	-	-
13	KV dhe DFDIL Familjar	-	-
	Kthimet nga skemat e ndryshme	-	-157,234
Gjithsej		5,142	926,553

Shkak për këtë gjendje ishte mungesa e interpretimit përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale.

Ndikimi

Pagesat e pensioneve të dyfishta për personat e njëjtë pa një interpretim të bazës ligjore nga organet përgjegjëse mund të dëmtojnë buxhetin e Ministrisë

Rekomandimi C1

Ministri i MPFVLÇ duhet të inicojë procedurat për të bërë interpretim dhe vlerësim të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore në lidhje me pensionet e dyfishta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B2 - Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes****Gjetja**

Sipas nenit 10.4.2 të Ligjit Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti, pensionet e parakohshme "Trepça" ndërpriten së paguari, nëse personi punësohet apo vetëpunësohet.

Më tutje, sipas nenit 16A.5 të Ligjit Nr.05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L -261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Veteranët e Luftës së UÇK-së, të cilët punojnë jashtë institucioneve që paguhen nga Buxheti i Kosovës, si dhe jashtë ndërmarrjeve publike, do të gëzojnë pensionin njëtrajtshëm sipas paragrafit 4 të këtij neni, deri në 50% të shumës së paraparë, por, që në total nuk do të kalojë buxhetin prej 0,7% të Bruto Prodhimit Vendor; si dhe

Sipas nenit 4.4 të ligjit Nr.04/L-096 për skemën e ndihmës sociale ndalon të drejtën për ndihmë sociale për persona të punësuar.

a.) Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar - Nga krahasimi i të dhënave të MFPT-së për skemat pensionale dhe ndihmat sociale me të dhënat e ATK-së, kemi vërejtur se ekzistojnë raste të përfitimit të pensioneve nga persona të cilët punojnë apo realizojnë të ardhura personale. Vlera e gabimit financiar për vitin 2025 ishte 259,392€. Për dallim nga viti paraprak nuk kemi identifikuar raste të tilla tek skema - Ndihma sociale.

Tabela 2. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar

Nr.	Lloji i Skemës	Numri i pagesave	Gabimi Financiar (EUR)
1	Ndihma Sociale	-	-
2	Pensionet Trepça	25	3,780
3	DFDIL Veteran	1,253	255,612
Gjithsej		1,278	259,392

Tabela 3. Pensionet e paguara pas vdekjes

Lloji i pensionit (Skemës Pensionale)	Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para vitit 2025		Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë vitit 2025		Gjithsej pagesat pas vdekjes së përfituesve	
	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)
Skema e të verbërve	9	2,550	1	300	10	2,850
Pensionet Bazë	205	33,660	75	9,120	280	42,780
Pensionet Kontributive	59	14,120	6	1,862	65	15,983
Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK)	69	9,000	14	1,680	83	10,680
Pensionet e Parakohshme të Trepçës	1	151	-	-	1	151
Arsimi	13	1,130	2	204	15	1,334
Pensionet e TMK-se	-	-	2	602	2	602
DFDIL Veteran	31	5,896	1	204	32	6,100
Pensionet për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët (PPTP)	23	8,505	6	2,025	29	10,530
Totali	410	75,012	107	15,997	517	91,010

b.) Pensionet e paguara pas vdekjes - Nga krahasimi i të dhënave/regjistrave ndërmjet MFPT-të dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil kemi gjetur se gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 517 pagesa, në vlerë 91,010€ për pensione pas vdekjes së përfituesve. Kjo është në kundërshtim me ligjet përkatëse të skemave pensionale dhe rregullave të aplikueshme ku përcaktohet se pensionet duhet të ndalen pas vdekjes.

Pagesat pas vdekjes së përfituesve, ndodhin kryesisht si rezultat i lajmërimit me vonesë apo edhe kur vdekjet e përfituesve nuk ishin regjistruar me kohë në ARC, dhe ministria nuk kishte informata për rastet.

Ndikimi

Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar dhe mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave shkaktojnë pagesa të parregullta, duke dëmtuar kështu buxhetin e Ministrisë.

Rekomandimi B2

Ministri i MPFVLÇ duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër dhe të shqyrtoj mundësitë për kthimin e tyre nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontroleve të brendshme në mënyrë që të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet databazave të skemave pensionale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mbajtja e pozitave të punës me ushtrues detyre/zëvendësues

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 08/L-257 për administrimin e procedurave tatimore, përkatësisht neni 78 përcakton: Pozita e lirë e punës mund të plotësohet me anë të emërimit të përkohshëm të zyrtarit të ATK-së në atë pozitë deri në dymbëdhjetë (12) muaj, me kusht që zyrtari i ATK-së plotëson kriteret për t'u emëruar përkohësisht në atë pozitë.

Nga të dhënat e pranuar nga departamenti i burimeve njerëzore, ATK mban 81 pozita të punës me vendime për ushtrues detyre/zëvendësimit. Prej tyre 58 pozita mbahen për një periudhë më të gjatë kohore (prej 22-41 muaj). Vendimet për caktim të zyrtarëve në fjalë si zëvendësues, janë marrë në vitet 2022 - 2024, mbi bazën e një legjislacioni tashmë të shfuqizuar, si dhe deri në përfundim të auditimit tonë, nuk ishin bërë harmonizimet me ndryshimet dhe kornizën e re ligjore.

Kjo ka ndodhur për shkak se institucioni nuk e kishte përfunduar procesin e ristrukturimit dhe sistematizimit të vendeve të punës duke i harmonizuar me legjislacionin përkatës, procese këto që paraqesin bazë për zhvillimin e procedurave të rregullta të rekrutimit dhe plotësimin e pozitave.

Ndikimi Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor dhe mos-plotësimi i tyre me staf të rregullt, mund të ndikoj në efikasitetin operacional dhe arritjen e objektivave strategjike të entitetit.

Rekomandimi A1 Ministri i Financave përmes Drejtorit të ATK-së duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për përfundimin e procesit të ristrukturimit dhe harmonizimit të akteve të brendshme, me qëllim të plotësimin të pozitave përmes procedurave të rregullta të rekrutimit dhe shmangies së mbajtjes së tyre për periudha të gjata me ushtrues detyre/zëvendësues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A2 - Mos përdorimi i sistemit e-prokurimi për modulën e kontratave**

Gjetja Sipas Rregullores nr. 001/2022 të KRPP, konkretisht nenit 70.1 dhe paragrafit 70.24.f, administrimi i kontratave duhet të realizohet përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi). Ky paragraf përcakton se Menaxheri i Kontratës është i obliguar të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mirëmbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhimin e kontratës në sistemin e prokurimit elektronik.

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit në MFPT (përfshirë Doganën dhe ATK), verifikuam që procesi i menaxhimit, përkatësisht implementimit të kontratave nuk është duke u zhvilluar përmes moduleve përkatëse të platformës elektronike të prokurimit publik, siç kërkohet me rregulloren në fuqi.

Kjo vjen kryesisht si rezultat i anashkalimit të detyrimeve ligjore, si dhe mungesës së njohurive dhe trajnimeve të mjaftueshme lidhur me përdorimin e moduleve elektronike për menaxhimin dhe vlerësimin e kontratave.

Ndikimi Moszhvillimi i proceseve përmes platformës elektronike e bën menaxhimin e kontratave më pak transparent si dhe e pamundëson që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A2 Ministri i Financave në bashkëpunim me Drejtorët e Doganës dhe ATK-së, duhet të sigurojë që menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve të realizohet përmes platformës e-prokurimi, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si: mallrat e shërbime, subvencione e transfere dhe investimet kapitale.

Çështja B3 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Ne identifikuar se ishin paguar dhe regjistruar shpenzime në kategori ekonomike joadekuate në vlerë prej 96,109€ si në vijim:

- Tri pagesa përmes vendimeve gjyqësore nga MFPT në vlerë prej 41,391€ që kishin të bënin me të drejtën e kompensimit për skema sociale, ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale. Prej tyre shpenzimet në vlerë 36,016€ i takonin kategorisë subvencione dhe transfere, ndërsa shpenzimet përmbartimore, të gjykatave dhe të interesit në vlerë 5,375€ i takonin kategorisë mallra dhe shërbime;
- Dy pagesa përmes vendimeve gjyqësore në vlerë 26,273€ për kompensim të skemave sociale, ishin ekzekutuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ku prej tyre shpenzimet në vlerë 22,866€ ishin keqklasifikim pasi që i takonin kategorisë subvencione dhe transfere, kurse 3,407€ ishin shpenzime përmbartimore dhe të interesit dhe pagesa e tyre ishte nga kategoria adekuate;
- Në katër pagesa në vlerë 201,430€ të ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore nga kategoria subvencione dhe transfere, shuma prej 21,299€ për shpenzime interesi ishte paguar nga kategoria jo adekuate, pasi këto shpenzime për nga natyra i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime; dhe
- Blerja e 12 kompjuterëve për Njësinë e Integjencës Financiare në vlerë 10,553€ ishte realizuar nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera individuale e kompjuterëve ishte nën 1,000€ dhe rrjedhimisht është dashur të paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ka ndodhur si rezultat i vendimeve gjyqësore dhe kontrolleve jo të mjaftueshme me rastin e planifikimit, ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve ndikojnë në mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe rrjedhimisht në paraqitje jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B3

Ministri i Financave dhe Ministri i MPFVLÇ duhet të sigurojnë që shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Po ashtu, pagesat me vendime gjyqësore duhet të realizohen nga kategoria adekuate e shpenzimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 24,389,036€, pasurive jokatitale është 1,186,936€, si dhe e stoqeve 676,938€.

Çështja B4 - Mangësi në regjistrimin e pasurive

Gjetja Sipas nenit 6, pikës 3 të Rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Nga testimet dhe analizat e regjistrimit të pasurive kemi identifikuar se pasuritë e Ministrisë ishin të nënvlerësuara për 151,712€, pasi që:

- Ministria nuk kishte evidentuar në regjistrin e pasurive një pagesë në vlerë 108,490€ që kishte të bënte me blerje të pajisjeve tjera të IT-së (Rikuperim i të dhënave); dhe
- Projekti “Renovimi i zyrës së pensioneve në Mitrovicë”, ishte i nënvlerësuar në vlerë neto për 43,222€ në regjistrin e pasurisë, si pasojë e mos-regjistrimit të dy pagesave (situacioni 2 dhe 3).

Dobësitë e identifikuar kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme gjatë regjistrimit të pasurive.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive dhe raportimi jo i duhur i tyre pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nën nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të saktë të tyre në PFV.

Rekomandimi B4 Ministri i Financave dhe Ministri i MPFVLÇ duhet të sigurojnë se të gjitha njësitë brenda ministrisë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi që regjistri i pasurive të korrigjohet dhe plotësohet nga gabimet e identifikuar në mënyrë që vlera e pasurive të jetë e plotë dhe e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë me kohë

Gjetja Sipas Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 19, thekson se raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Dogana e Kosovës, nuk kishte arritur të kryej procesin e inventarizimit para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore (inventarizimi i pasurisë ka përfunduar me datë 23.03.2026), duke pamundësuar që të bëhet me kohë, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive jo financiare.

Edhe pse komisioni ishte formuar në kohën e duhur, nuk kishte arritur të jetë mjaftueshëm efikas që ky proces të përfundohej para përgatitjes së

pasqyrave financiare vjetore

Ndikimi

Mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë me kohë, rritë rrezikun që ndryshimet eventuale të konstatuara nga procesi i inventarizimit të mos reflektohen në regjistrat e pasurive të prezantuara në Pasqyra Financiare.

Rekomandimi B5

Ministri i Financave përmes Drejtorit të Doganës, duhet të siguroj proces më efikas të kryerjes së inventarizimit të pasurisë para përgatitjes së pasqyrave financiare, në mënyrë që të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe rrjedhimisht të bëhet prezantim i saktë dhe i plotë i gjendjes së pasurive në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Ministria në PFV-të e vitit 2025 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 779,680,187€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e Doganës së Kosovës prej 60,927,402€, nga të arkëtueshmet e ATK-së prej 716,270,760€, Inspektoriatit të Punës 2,260,025€ dhe Njësisë së Inteligjencës Financiare 222,000€.

Çështja B6 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme/ borxheve të vjetra

Gjetja ATK për vitin 2025 në planin e punës kishte përcaktuar që të inkasohen borxhet në vlerë 277,320,010€. Gjithashtu, në planin punës ishte paraparë ndërmarrja e iniciativave për të pastruar stokun e borxhit nga të gjitha borxhet e pa mbledhshme.

Sipas të dhënave të raportuara nga ATK, gjatë vitit 2025 ishin mbledhur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 229,665,394€. Krahasuar me planin e punës janë mbledhur 83% e borxheve të planifikuara, pothuajse në të njëjtin përqindje krahasuar me vitin paraprak. Sa i përket mbledhjes së borxheve të vjetra (borxhet e pa mbledhshme), vlera e tyre në fund të vitit 2025 ishte rritur për 3,065,323€ krahasuar me vitin paraprak (në vitin 2025 vlera e tyre ishte 141,358,011€, kurse në 2024 ishte 138,304,341€).

Rritja është rezultat i aplikimit të ndëshkimeve dhe interesit që aplikohen në sistem. Rritja e stokut të borxhit të vjetër mbetet një sfidë e vazhdueshme, e ndikuar kryesisht nga ndërprerja e aktivitetit operativ të bizneseve.

Ndikimi Niveli i ulët i arkëtimit të borxheve të vjetra rritë stokun e borxheve të akumuluar, të cilat me kalimin e kohës shndërrohen në borxhe të pambledhshme.

Rekomandimi B6 Ministri i Financave dhe Drejtori i ATK-së duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve, me theks të veçantë në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra bazuar në kërkesat ligjore përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Paraqitje jo e saktë e llogarive të arkëtueshme në PFV

Gjetja Bazuar në Regulloren nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, përcakton që "Organizatrat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara të pa arkëtuara".

ATK, në PFV kishte prezentuar llogari të arkëtueshme në vlerë 716,270,760€. Kjo gjendje ishte e nënvlerësuar për 4,271,769€ si pasojë e paraqitjes së vlerës së tyre deri me datë 25.12.2025 dhe jo sipas datës së fundit të vitit fiskal. (gjendja e llogarive të arkëtueshme më 31.12.2025 ishte 720,542,529€).

Po ashtu, nga testimet e mostrave të auditimit kemi identifikuar se në një (1) rast në vlerë 214,095€, ATK nuk kishte larguar nga lista e llogarive të arkëtueshme tatimpaguesin i cili kishte shlyer obligimet (transfer kredie) ndaj ATK-së brenda vitit 2025, duke e mbivlerësuar gjendjen e llogarive të

arkëtueshme për këtë vlerë.

Kjo pasaktësi ka ardhur si rezultat i mosraportimit të llogarive të arkëtueshme sipas gjendjes në datën e fundit të vitit raportues dhe dobësive në kontrollet e brendshme për paraqitjen e saktë të obligimeve të tatimpaguesve në regjistrin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Kjo ndikon në paraqitjen jo të saktë të llogarive të arkëtueshme dhe obligimeve të tatimpaguesve në pasqyrat financiare. Po ashtu, kjo mund të ndikojë negativisht edhe në planifikimin dhe projeksionet e të hyrave për inkasim në periudhat pasuese financiare.

Rekomandimi A3

Ministri i Financave përmes Drejtorit të ATK-së duhet të sigurojë që llogaritë e arkëtueshme të paraqiten në PFV në mënyrë të saktë dhe të plotë, bazuar në gjendjen e tyre në datën e fundit të vitit raportues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2025, ishte 15,644,697€.

Çështja B7 - Mbivlerësim i regjistrit të detyrimeve kontingjente

Gjetja Rregullorja MF nr.01/2017, neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PVF. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

Regjistri i detyrimeve kontingjente në PFV ishte i mbivlerësuar për 126,168€, për shkak se:

- Tri lëndë në vlerë 51,374€ të Doganës së Kosovës (DK) ishin përfshirë në regjistrin e detyrimeve kontingjente edhe pse procesi gjyqësor për to kishte përfunduar me vendim të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale; dhe
- Pesë lëndë të Ministrisë, përkatësisht të Departamentit të pensioneve në vlerë 74,794€, ishin paraqitur si detyrime kontingjente edhe pse për këto këto lëndë procesi gjyqësor kishte përfunduar. Në tri raste kishte aktgjykim të shkallës së dytë nga Gjykata e Apelit. Ndërsa dy rastet tjera ishin të përfunduara me aktgjykim të Gjykatës Themelore (shkalla e parë), por ministria nuk kishte ushtruar ankesë ndaj këtyre vendimeve në Gjykatën e Apelit duke e pranuar vendimin e shkallës së parë.

Mos përditësimi i listës së detyrimeve kontingjente nga zyra ligjore me të dhënat e fundit nga proceset kontestimore ishte shkaktari kryesor i mbivlerësimit të detyrimeve kontingjente

Ndikimi Mos raportimi i saktë i detyrimeve kontingjente ka ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente në PFV.

Rekomandimi B7 Ministri i MPFVLÇ dhe Drejtori i DK, duhet të sigurojnë kontrolle më efektive në përditësimin e regjistrit të detyrimeve kontingjente, me qëllim që gjendja e tyre të prezantohet saktë dhe drejtë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Ministria ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, gjithashtu njësi të veçanta të auditimit të brendshëm janë të themeluara edhe në Doganë të Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Thesarin e Kosovës. Këto njësi ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur, në përputhje me parimet e pavarësisë funksionale dhe organizative të auditimit të brendshëm. Të gjitha njësitë kishin të përgatitura planet strategjike dhe ato vjetore të auditimit.

Çështja A4 - Mos themelimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik përcakton: Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Komiteti i auditimit nuk ishte funksional gjate vitit 2025 në MFPT. Pas dorëheqjes së Kryesuesit të Komitetit të Auditimit në fund të vitit 2024, Ministria nuk kishte emëruar komitetin e ri.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve të ndërmarra nga ministria për themelimin e Komitetit të Auditimit.

Ndikimi

Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit ndikon në dobësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies, duke rritur rrezikun për mosadresim me kohë të gjetjeve dhe dobësive në kontrollin e brendshëm.

Rekomandimi A4

Ministri i Financave duhet të sigurojë që në afat sa më të shkurtë kohor të funksionalizoj Komitetin e Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NJAB-së, duke siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1

Pasaktësi në prezantimin e të dhënave në PFV

Gjetja

Në PFV e MFPT-së për vitin 2025 janë identifikuar disa pasaktësi në prezantimin e të dhënave, të cilat i kemi shpalosur më poshtë:

- Tek Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - Hyrja e Parasë së Gatshme, përkatësisht tek Kthimet - rimbursimet, kishte një mospërputhje në mes vlerës së paraqitur dhe shënimit shpjegues 12a, përkatësisht vlera e paraqitur në shënimin shpjegues ishte e nënvlerësuar për 6,769,000€;
- Tek, Shënimi 8 - Të hyrat tatimore, vlera në total e të hyrave tatimore ishte paraqitur saktë por kishte gabime në shpalosje të vlerave në kode individuale të të hyrave; dhe
- Tek Neni 24 - Raporti për fondet e donatorëve të pashpenzuara-totali në dispozicion i fondeve të donatorëve sipas të dhënave në SIMFK ishte 390,661€ ndërsa në PFV ishte paraqitur 396,071€ pra me një diferencë prej 5,410€.

Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për t'i korigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati

Menaxhmenti kishte marrë veprime korigjuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PVF e vitit vijues atëherë çështja do të rezultoj me rekomandim në raportin e auditimit.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,021,101,596	1,043,949,412	1,024,401,237	863,933,407	823,917,867
Grante Qeveritare - Buxheti	1,002,101,596	1,025,227,339	1,016,121,174	844,815,172	789,689,804
Financimi përmes huamarrjes	17,000,000	16,627,900	7,741,538	1,385,937	6,553,522
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	2,000,000	1,703,512	294,420	17,368,410	22,631,590
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	0	0	0	4,773,878
Donacionet vendore	0	110,768	110,670	153,000	114,750
Donacionet e jashtme	0	279,893	133,435	210,888	154,323

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 22,847,816€. Ky ndryshim është rezultat i rritjes së buxhetit nga granti qeveritar dhe nga fondet e donatorëve, si dhe zvogëlimi i buxhetit nga huamarrja dhe klauzola e investimeve.

Në vitin 2025 MFPT ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 1,024,401,237€, me një përmirësim 4% në krahasim me vitin 2024. Zbatimi i buxhetit nga financimi përmes huamarrjes dhe klauzoles së investimeve mbetet në një nivel të pakënaqshëm.

Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,021,101,596	1,043,949,412	1,024,401,237	863,933,407	823,917,867
Pagat dhe mëditjet	75,382,310	24,210,859	24,206,062	21,517,579	21,364,773
Mallrat dhe shërbimet	15,067,000	13,626,416	10,719,517	9,190,508	9,062,167
Komunalitë	1,197,576	680,476	504,670	497,550	391,981
Subvencionet dhe transferet	914,564,710	995,567,521	985,181,665	827,845,998	788,767,186
Investimet Kapitale	14,890,000	9,864,139	3,789,322	4,881,773	4,331,759

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 51,171,451€. Ky ndryshim ishte rezultat i kontingjencave në vlerë 50,894,348€ dhe pjesa tjetër prej 277,103 ishte me vendime të Qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 100%;


Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,440,584€. Përmes vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe kursimeve buxhetore kishte zvogëlim në vlerë 1,562,800€ si dhe kishte rritje nga donacionet në vlerë 122,216€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 79%;

Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 517,100€ si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime në fund të vitit fiskal. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 74%;

Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 81,002,811€. Si rezultat i vendimeve qeveritare kishte rritje në vlerë 80,737,999€ si dhe rritje nga donacionet në vlerë 264,812€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 99%; si dhe

Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 5,025,861€. Investimet kapitale ishin zvogëluar për 5,026,937€ me vendime të Qeverisë (përfshirë klauzolen e investimeve që ishte zvogëluar për 296,488€) dhe nga donacionet kishte rritje prej 1,076€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte vetëm 38%. Ky nivel i ulët i realizimit në përgjithësi ishte rezultat i mos inicimit të procedurave të prokurimit për një numër të caktuar të projekteve, si dhe anulimit dhe vonesave në kontraktim si pasojë e ankesave gjatë procesit të prokurimit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e planifikuara për MFPT sipas Ligjit nr.08/L-332 për ndarjet buxhetore për vitin 2025 ishin 2,887,979,000€. Krahasuar me planifikimin, MFPT përfshirë (Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore) kishte arritur të realizonte të hyra neto 2,946,206,981€.

Të hyrat bruto të realizuara në vitin 2025 nga Dogana e Kosovës ishin 1,962,419,573€, ndërsa realizimi neto ishte 1,959,040,694€, (të hyrat bruto 1,962,419,573€ - 3,378,879€ kthimet). Krahasuar me vitin 2025, këtë vit kishte rritje në realizim për 7%.

Ndërsa, Administrata Tatimore e Kosovës kishte arritur të realizonte të hyra bruto në vlerë 1,052,932,512€, ndërsa në vlerë neto realizimi ishte 979,639,555€ (të hyrat bruto 1,052,932,512€ - 73,292,958€ kthimet). Krahasuar me vitin e kaluar, kishte një rritje në realizim për 11%.

Sa i përket njësive të tjera, Thesari i Kosovës ka inkasuar 5,962,458€, duke shënuar një rrënjë prej 43% krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat e realizuara nga Thesari kryesisht kanë të bëjnë me të hyra nga interesi i akumuluar i Thesarit dhe të hyra nga interesi bankar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Agjencitë / Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	Të hyrat neto 2025	Të hyrat neto 2024	Të hyrat neto 2023
Totali i të hyrave	3,022,878,817	-76,671,836	2,946,206,981	2,719,611,037	2,617,990
Administrata tatimore e Kosovës	1,052,932,512	-73,292,958	979,639,555	879,375,717	0
Dogana e Kosovës	1,962,419,573	-3,378,879	1,959,040,694	1,827,773,012	0
Inspektoriat i Punës	1,466,314	0	1,466,314	1,745,223	1,138,140
Njësia e Inteligjencës Financiare	0	0	0	3,281	127,128
Administrata Thesari i Kosovës	5,962,458	0	5,962,458	10,436,549	1,231,611
Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale	0	0	0	0	0
Shërbimet e punësimit	52,945	0	52,945	15,030	32,220
Administrata Qendrore - MF	44,915	0	44,915	180,359	59,720
Agjencia Qendrore e Prokurimit	101	0	101	81,866	29,171

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të MFPT ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime. MFPT ka përgatitur Planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, një (1) rekomandim është zbatuar, një (1) ishte në proces, dhe shtatë (7) nuk janë zbatuar ende siç është paraqitur në Grafikon 2.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 7 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj menaxhim efikas në procesin e kthimeve/rimbursimeve, në mënyrë që kërkesat për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar ligjor. Në rastet e vonesave nga ATK duhet të aplikohet pagesa e interesit për tatim paguesit.	Edhe këtë vit kemi vonesa në shqyrtimin e kërkesave për rimbursim.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të iniciojë procedurat për të bërë interpretim dhe vlerësim të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore në lidhje me pensionet e dyfishta.	Ka përmirësime të lehta krahasuar me vitin e kaluar.	Pjesërisht i zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër dhe të shqyrtoj mundësitë për kthimin e tyre nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet databazave të skemave pensionale.	Edhe këtë vit janë identifikuar mangësi.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për konkluzion	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së duhet të forcojnë kontrollet e brendshme dhe të sigurohen se praktikat e tilla të pagesave nuk aplikohen në të ardhmen. Po ashtu, para ekzekutimit të çdo pagese të sigurohen se janë pranuar furnizimet me qëllim që të arrihen objektivat për të cilin është shpenzuar paraja publike.	Nuk kemi hasur në raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Po ashtu, pagesat me vendime gjyqësore duhet të realizohen nga kategoria adekuate e shpenzimit.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MFPT-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë e drejtë dhe e saktë.	Edhe këtë vit kemi identifikuar disa pasuri të pa regjistruara.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Pasuritë	Ministri, duhet të siguroj se para përgatitjes së pasqyrave financiare të bëhet inventarizimi i gjithë pasurisë në kuadër të MFPT-së si dhe krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV për vitin 2025.	Ministria kishte kryer inventarizimin me kohë këtë vit, por rekomandimi mbetet i përsëritur pasi që në Doganën e Kosovës nuk është kryer brenda afatit ligjor ky proces.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra bazuar në kërkesat ligjore përkatëse.	Në raport me vitin paraprak ka rritje të borxhit të vjetër të pa inkasuar.	Nuk ka filluar zbatim

9.	Detyrimet Kontigjente	Ministri, duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	Këtë vit janë identifikuar raste të mbivlerësimit të regjistrat të detyrimeve kontigjente në Ministri dhe Doganë.	Nuk ka filluar zbatimi
----	-----------------------	---	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Fjolla Bakalli Sadiku, Udhëheqëse e ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



Veton Misiri, Anëtar i ekipit



Pleurat Isufi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 11-06-2026			
KODI I KLASIFIKIMIT			
Nivela Org. Org. Unit	Shif. Klasif. Class. Code	Nr. Prot. Prot. No.	Nr. Fajese Serif. No.
03	47	1064	1



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO			
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT			
MINISTRIA E FINANÇAVE - MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE			
Nivelo Org. Org. Unit	Nr. Prot. Prot. No.	Data Date	
01/150	1223/2026	17.06.26	
PRISHTINE / PRISTINA / PRISHTINA			

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Kabineti i Ministrimit - Kabinet Ministra - Minister's Cabinet

17.06.2026

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve** për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.